



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1095/ 14 prot.

Datë 02.06.2025

V E N D I M

Nr. 730/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.06.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.658/2025, datë 14.05.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Shërbime” me nr. REF-43128-04-01-2025, me objekt: “Hartim i projekt-preventivit për rikonstruksionin e godinave të IEVP Fushë Krujë”, me fond limit 2,170,986.99 (dy milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 14.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “MIKI CONSULTING” SHPK me NIPT K87628701K dhe adresë Shkodër, Lagjja Vasil Shanto, Rruga Vaso Kadia, godinë nr 1/506.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara me adresë Rruga: “Reshit Çollaku”, Godina nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për

Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 14.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.658/2025, ku vendosi:

1. *Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MIKI CONSULTING” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Shërbime” me nr. REF-43128-04-01-2025, me objekt: “Hartim i projekt-preventivit për rikonstruksionin e godinave të IEVP Fushë Krujë”, me fond limit 2,170,986.99 (dy milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 14.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.*
2. *Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare, të paguar nga operatorit ekonomik “MIKI CONSULTING” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me nr. 1037/11 prot., datë 29.05.2025, protokolluar me tonën nr. 1095/11 prot., datë 02.06.2025, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 658/2025, datë 14.05.2025, si vijon: “.....*meqënëse në Vendim statusi i ankimuesit dhe i procedurës së prokurimit publik nuk ndryshon, në mënyrë që të vazhdohet me njoftimin e fituesit përfundimtar, lutemi të lejohet AK për të vazhduar me hapat e mëtejshëm procedural*”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën me nr. 1037/11 prot., datë 29.05.2025, protokolluar me tonën nr. 1095/11 prot., datë 02.06.2025, autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 658/2025, datë 14.05.2025, si vijon: “.....*meqënëse në Vendim statusi i*

ankimuesit dhe i procedurës së prokurimit publik nuk ndryshon, në mënyrë që të vazhdohet me njoftimin e fituesit përfundimtar, lutemi të lejohet AK për të vazhduar me hapat e mëtejshëm procedural”.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar nëpërmjet shërbimit postar me shkresën me nr. 1037/11 prot., datë 29.05.2025, protokolluar me tonën nr. 1095/11 prot., datë 02.06.2025, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer zbatuar vendimin KPP 658/2025 datë 14.05.2025.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar, Shërbime*” me nr. REF- 43128-04-01-2025, me objekt: “*Hartim i projekt-preventiv për rikonstruksionin e godinave të IEVP Fushë Krujë*”, me fond limit 2,170,986.99 (dy milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë nentëdhjetë e nëntë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 14.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

